Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 09
Prishtinë, më 2.11.2020, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Miljana Nikoliq, kryetare e komisionit; Albert Kinolli, zëvendëskryetar i parë, Fetah Rudi, zëvendëskryetar i dytë; Ivan Todosjiviq, Zoran Mojsiloviq, Igor Simiq, Milosh Peroviq, Ljubinko Karadzhiq, Fidan Jilta, Veton Berisha, Adem Hoxha, Rasim Selmanaj, Rasim Demiri, anëtarë.

Munguan:, Elmi Reçica, Arbëreshë Krasniqi, Hajrulla Çeku, Arbër Rexhaj dhe Etem Arifi.

Pjesëmarrës tjerë: Elmedina Beka nga GP-LDK; Zijush Ahmeti, SKKK dhe Celal Iliaz, Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Natasa Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Miljana Nikoliq**, kryetare e komisionit (tutje kryetare).

Rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.10.2020;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 07/L-05 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-48 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin nr.03/L221, me Ligjin nr. 04/L-116, me Ligjin nr. 04/L-194, me Ligjin nr. 05/L-063 dhe me Ligjin 05/L007, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Transfere;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.07/L-16 për rimëkëmbjen ekonomike- COVID-19, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Transfere;**
5. **Të ndryshme**

1. **Miratimi i rendit të ditës**

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës, unanimisht, pa ndryshime.

2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.10.2020**

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtura më 28.10. 2020, pa vërejtje.

3, Shqyrtimi i Projektligjit nr. 07/L-05 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-48 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin nr.03/L221, me Ligjin nr. 04/L-116, me Ligjin nr. 04/L-194, me Ligjin nr. 05/L-063 dhe me Ligjin 05/L007, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Transfere

Kryetarja tha se bazuar në referencat e nenit 57.8 dhe shtojca 2.2 të Rregullores së punës së Kuvendit, komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve është komision i përhershëm, i cili i shqyrton të gjitha ligjet që janë në procedurë. Komisioni, gjatë shqyrtimit të projektligjeve dhe raporteve të komisioneve funksionale, jep propozime në amendamente, nëse ka, ndërsa më pas del me rekomandime, në mënyrë që të sigurohen të drejtat dhe interesat e komuniteteve, të cilat trajtohen në mënyrë të barabartë dhe i procedon për miratim në Kuvend.

Ajo ftoi anëtarët e komisionit të paraqesin sugjerimet dhe propozimet e tyre të mundshme në raport, me amendamentet e bashkangjitura.
Pasi nuk pati propozime shtesë, kryetarja dha dy propozime, që raporti me amendamente i Komisionit funksional të votohet në pako apo amendamentet një nga një.

Anëtarët e komisionit u pajtuan unanimisht, që raporti me amendamente i Komisionit funksional për Buxhet dhe Transfere, të votohet në pako.

Kryetarja konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 07/L-05 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-48 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin nr.03/L221, me Ligjin nr. 04/L-116, me Ligjin nr. 04/L-194, me Ligjin nr. 05/L-063 dhe me Ligjin 05/L007, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Buxhet dhe Transfere, nuk janë miratuar nga ana e komisionit.
3. Gjatë shqyrtimit të raportit me amendamente, rezultatet e votimit janë: PËR (5), KUNDËR (0) ABSTENIM (1), të tjerët nuk kanë marrë pjesë në votim dhe u konstatua se i njëjti nuk ka marrë shumicën e votave të nevojshme për miratim

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.07/L-16 për rimëkëmbjen ekonomike- COVID-19, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Transfere

Kryetarja theksoi se raporti është i hartuar me dy propozime, amendamentet e propozuara të Komisionit funksional për Buxhet dhe Transfere dhe amendamentet e deputetëve të caktuar, të cilat nuk e kanë marr përkrahjen e Komisioni funksional dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të përcaktohen për mënyrën e votimit.

Ajo propozoi që raporti me amendamente i Komisionit funksional, të votohet në pako apo amendamentet një nga një.
Anëtarët e komisionit u pajtuan unanimisht, që raporti me amendamente i Komisionit funksional për Buxhet dhe Transfere, të votohet në pako.

Kryetarja konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr.07/L-16 për rimëkëmbjen ekonomike - COVID-19, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Buxhet dhe Transfere, nuk janë miratuar nga ana e komisionit.
3. Gjatë shqyrtimit të raportit me amendamente, rezultatet e votimit janë: PËR (6), KUNDËR (0) ABSTENIM (0), të tjerët nuk kanë marrë pjesë në votim dhe u konstatua se i njëjti nuk e ka marrë shumicën e votave të nevojshme për miratim.

3. Të ndryshme

Veton Berisha, theksoi se në mbledhjen e mbajtur më 20.10.2020, me iniciativën time, komisioni ka miratuar propozimin për formimin e grupit punues për nismën legjislative për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Festat Zyrtare. Ai e informoi komisionin se në konsultim me disa anëtarë të këtij grupi punues, kemi marrë qëndrim se nevojitet edhe pak kohë, për të filluar punën ky grup. Në ditët në vijim, do t'ju informojë për mbajtjen e takimit të parë, të grupit punues.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.
Përgatitur nga: Njësia mbështetëse e komisionit.

Kryetare e komisionit,

Miljana Nikoliq